



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 839 Prot.

Tiranë, më 10.06 2019

VENDIM Nr. 160, datë 6.06.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje" (i ndryshuar). Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 7. të datës 6.06.2019, pasi shqyrtoi kërkesën e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore e ASHK-së Lezhë, për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "*Godinë banimi 2 kate*" të Znj. Dava Zef Gega, Lagjja e Spitalit, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Lezhës,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore e ASHK-së Lezhë, për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "*Godinë banimi 2 kate*" të Znj. Dava Zef Gega, Lagjja e Spitalit, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Lezhës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**